



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

Janar 2023

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Përmbajtja

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE	- 3 -
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	4
Raporti i ekzekutimit të buxhetit.....	5
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	6
Shënimi 1 Politikat kontabël.....	6
Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit.....	27
Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale	29
Shënimi 2 Paga dhe rroga	29
Shënimi 3 Mallra dhe shërbime	30
Shënimi 4 Shpenzime komunale	32
Shënimi 5 Subvencione dhe transfere	33
Shënimi 6 Shpenzime kapitale.....	33
Shënimi 7 Tjera.....	34
Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve	35
Shënimi 12 Tjera.....	37
Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta.....	37
Neni 16 Raport për të arkëtueshmet.....	38
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara	39
Neni 18 Detyrimet kontingjente.....	39
Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare	39
Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara.....	41
Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara.....	42
Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim.....	42
Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara	42
Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara	42
Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave.....	42
Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	44
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta	44
Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)	45

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **NYSRET KOCA, zv. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **ENVER FEJZULLAHU, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

FATON FETOSHI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2022.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 të Akademisë së Drejtësisë.

Data: __/__/____

Datë: __/__/____

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Akademinë e Drejtësisë
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022

		2022	2021	2020
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
		'000	'000	'000
Shënim				
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
	Granti qeveritar	584	489	449
	Të hyrat vetanake			
	Të hyrat e dedikuara			
	Të hyrat nga AKP		-	-
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	25	12	6
	Klauzola e investimeve			
	Fondi zhvillimor në mirëbesim			
	Pranimet tjera			
Gjithsej		608	501	454
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
	Operacionet			
	Paga dhe rroga	213	213	219
	Mallra dhe shërbime	388	281	228
	Shpenzime komunale	8	7	7
		608	501	454
	Transferet			
	Transfere dhe subvencione	5		
	Shpenzime kapitale			
	Prona, ndërtesa dhe pajisje	6		
	Pagesa tjera	7		
Gjithsej		608	501	454

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Akademinë e Drejtësisë
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

		2022				2021	2020
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shënime							
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8				-		
Të hyrat jo tatimore	9				-		
Të hyrat e dedikuara	10			-	-		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	27	27		-	16	15
Tjera	12				-		
Gjithsej Pranimet		27	27	-	-	16	15
DALJA E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe shtesa	2	213	244	244	31	213	219
Mallra dhe shërbime	3	388	427	400	39	281	228
Shpenzime komunale	4	8	17	17	9	7	7
Transfere dhe subvencione	5			-	-		
Shpenzime kapitale	6		-	-	-		
Rezerva					-		
Tjerat	7				-		
Gjithsej pagesat		608	687	660	79	501	454

Shënimi 1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Me Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë (AD), Akademia themelohet si institucion publik i pavarur, funksionet kryesore të të cilit janë, hartimi i programit trajnues dhe organizimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnimin për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira, zhvillimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime, kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore, kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

AD organizon trajnime me standarde të larta profesionale dhe me metoda efektive në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve të cilat kanë në fokus mandatin ligjor dhe përfituesit e AD-së.

Organet kryesore të AD-së janë: Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, ku përgjegjësitë e të cilëve janë të përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të AD-së, përveç Këshillit Drejtues si organ udhëheqës dhe Këshillit Programor si organ profesional dhe këshillëdhënës, përfshihet edhe Zyra e Drejtorit të AD-së, Departamenti i Programeve dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

Aktualisht AD, realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Në kuadër të këtyre programeve trajnuese përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative, e të cilat paraqesin mandatin e Akademisë.

- **Misioni**

Akademia ofron trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Akademia është institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

Programi i Trajnimit Fillestar¹

Bazuar në ligj, Akademia e Drejtësisë është përgjegjëse për organizimin e trajnimit fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar (më tutje PTF) zgjatë 12 muaj dhe organizohet sipas kësaj strukture: model i kombinuar i teorisë dhe praktikës ku përfshihen të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare po ashtu përfshinë edhe trajnime me karakter interdisiplinar dhe shqyrtimin e rasteve nga praktika gjyqësore, zhvillimi i shkathtësive në përfaqësim, simulime etj.

Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktikë zhvillohet në gjykata/prokurori ku ata janë emëruar dhe përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit ku fokusohet në zhvillimin e shkathtësive praktike me qëllimi të aplikimit të tyre pas përfundimit të trajnimit.

Programi trajnues është miratuara nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, sipas këtij programi, trajnimi teorik është i ndarë në sesione dhe realizohet përmes gjashtë (6) moduleve trajnues bazë për gjyqtar dhe pesë module për prokuror, e të cilat përbëhen nga gjithsejtë (49 nën-module). Trajnimi praktik realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrje

¹ Neni 19 Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

e mentorit, ndërsa AD monitoron këtë proces. Gjithashtu pjesë përbërëse e programi trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ju ofroj njohuri gjyqtarëve/prokurore të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikën që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar (PTF) gjatë viti 2022

Trajnimit fillestar gjatë vitit 2022, e kanë ndjekur gjenerata e tetë e gjyqtarëve (24), gjenerata e nëntë e prokurorëve (6) dhe gjenerata e nëntë e gjyqtarëve (48), ku janë përmbushur objektivat e përcaktuar në Planin e Punës dhe Programin Trajnues gjithashtu të gjitha aktivitetet e paraparë janë realizuar komform kalendarit trajnues.

Gjenerata e tetë e gjyqtarëve (2021-2022)

Kjo gjeneratë ka filluar trajnimin me dt. 18 shkurt 2021, dhe ka përfunduar me 18 mars 2022. Në tre mujorin e parë të viti 2022, kanë realizuar gjithsejtë 51 ditë trajnim praktik dhe vizita në institucione jo gjyqësore kështu që kanë realizuar të gjitha aktivitetet e paraparë sipas programit trajnues. Këtë trajnime e kanë ndjekur 24 gjyqtarë.

Gjenerata e nëntë e gjyqtarëve të sapo emëruar (2022-2023)

Gjenerata e nëntë e gjyqtarëve të sapo emëruar, ka filluar trajnimin fillestar me 15 korrik 2022, programi trajnues është realizuar në mënyrë intensive e po ashtu i ndarë në dy grupe për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve i dizajnuar në mënyrë të ndarë ku fillimisht është realizuar trajnimi teorik i paraparë për 6 muaj të përfundoj në tërësi me dy lëmit. Gjatë viti 2022, janë realizuar 5 muaj trajnim teorik, në total janë realizuara 206 aktivitete trajnuese prej tyre 103 ditë trajnimi për secilin grup.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore dhe gjykime të simuluar, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe akteve të tjera ndërkombëtare. Sipas programit trajnues fillestar për gjyqtarët janë realizuar shtatë (6) module trajnuese (të cilat përbëhen nga 45 nën module).

Në këtë gjeneratë të ndarë në dy grupe në trajnim teorik në total janë realizuar 408 sesione trajnues apo 1224 orë trajnim. Këtë program deri në fillim të nëntorit e kanë ndjekur 48 gjyqtar ku një prej tyre tre të komunitetit serb dhe një boshnjak. Gjyqtarët serb kanë dhënë dorëheqje nga Gjykata Themelore Mitrovicë pas zhvillimeve të fundit në vend nga dt. 08 nëntor 2022, nga kjo datë nuk kanë vijuar trajnimin fillestar.

Gjenerata e nëntë e prokurorëve të sapo emëruar (2022-2023)

Gjenerata e nëntë e prokurorëve të sapo emëruar, ka filluar trajnimin fillestar me 04 korrik 2022, programi trajnues është realizuar në mënyrë të kombinuar të trajnimit teorik i realizuar në Akademinë e Drejtësisë dhe trajnimit praktik i realizuar në prokurori nën mbikëqyrjen e mentorit.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, raste specifike të simuluar. Sipas programit trajnues fillestar për prokurorët janë realizuar pesë (5) module trajnuese (16 nën- module janë trajtuar për prokurorët gjatë viti 2022). Në trajnimin fillestar për prokuror në total janë realizuar gjithsej 42 ditë trajnimi teorik, 82 sesione trajnuese apo 164 orë trajnimi dhe 70 ditë trajnim praktik.

Programi për Trajnimin Fillestar 2022

	Numri i pjesëmarrësve	Gjinia		Përkatësia Etnike			Totali i ditëve të trajnimit	Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktik	Sesionet Trajnuese	Orë Trajnimi	Trajner të angazhuar	Mentor të angazhuar
		M	F	S H	SR	TJ							
Gjenerata e e tetë (VIII) e gjyqtarëve	24	16	8	22	2	0	51	/	51	/	/	/	22
Gjenerata e nëntë (IX) e gjyqtarëve	48 ²	28	20	45	3	1	206	204	/	408	1224	35	/
Gjenerata e nëntë (IX) e prokurorëve	6	4	2	6	0	0	112	82	42	82	164	19	5

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm ka për qëllim zhvillimin e vazhdueshëm dhe avancimin e shkathtësive dhe ekspertizës së duhur profesionale dhe interdisiplinare, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Struktura e programit të trajnimeve të vazhdueshme përmban tema të karakterit kryesisht profesional duke i përfshirë edhe temat të karakterit interdisiplinar. Fushat që përfshinë PTV-ë: lëmia penale, lëmia civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, drejtësia komerciale, trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut – KEDNJ, trajnimet nga e drejta e Bashkimit Evropian, e drejta kushtetuese, lëmia për kundërvajtje, trajnimet për mos diskriminim, trajnimet e Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme, e drejta administrative si dhe Kompetenca interdisciplinare.

PTV organizon aktivitetet trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Me kërkesën e institucioneve kompetente dhe varësisht nga mundësitë, Akademia mund të organizoj trajnime edhe për avokatë shtetëror, avokatë, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues dhe administratorë falimentues. Në Programin e Trajnimeve të

² Deri me dt. 08 nëntor 2022, trajnimin fillestar e kanë ndjekur 48 pjesëmarrës, pas zhvillimeve të fundit në vend tre prej tyre kanë dhënë dorëheqje. Aktualisht trajnimin janë duke e ndjekur 45 gjyqtarë.

Vazhdueshme, janë realizuar aktivitetet trajnuese në formë të trajnimeve mirëpo nuk kanë munguar edhe tryezat. Aktivitetet janë trajtuar nga aspekti material po ashtu edhe ai procedural.


Krahas të arriturave dhe sukseseve, Akademia e Drejtësisë në realizimin dhe zbatimin e Programit Trajnues 2022, ka hasur edhe në sfida siç janë numri i madh i aktiviteteve trajnuese të inkuadruar jashtë programit trajnues 2022. Sfiduese ka qenë edhe angazhimi i trajnuesve marrë parasysh numrin e madh të aktiviteteve trajnuese si në PTV ashtu edhe në PTF, trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtar ligjor dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë vitit 2022 në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë në Akademisë së Drejtësisë janë realizuar një numër i konsiderueshëm i aktivitete trajnuese duke kombinuar kështu ekspertize vendore me atë ndërkombëtare me ç ‘rast i kanë bërë edhe me të fuqishme trajnime e realizuar në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, në kuadër të PTV-së janë realizuar: 143 aktivitete trajnuese. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto aktivitetet trajnuese ishte 3216, prej tyre 2005 kanë qenë gjyqtarë, 626 prokurorë, 163 bashkëpunëtor profesional, 43 zyrtarë ligjor, 20 mbrojtës të viktimave, 38 staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, 7 zyrtarë të Agjencisë për ndihmë Juridike Falas, 62 zyrtar nga Policia e Kosovës, 110 avokat, 25 ndërmjetësues, 3 zyrtar nga Dogana e Kosovës, 30 zyrtarë nga Shërbimi Sprovues, 4 zyrtar nga Qendra për Punë Sociale si dhe 80 pjesëmarrës nga institucionet tjera.

Programi për Trajnime të Vazhdueshme 2022			
Përfituesit	Trajnime/Tryeza	Ditë trajnimi	Pjesëmarrës
PTV	143	217	3216
Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor	23	23	748
Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistë tjerë ligjor	10	13	172
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	5	5	85
Zyra për Mbrojtjen e Viktimave	3	3	24

Përmbaues Privat	2	2	29
Trajnimet për Trajnues	7	21	100
Totali	193	284	4374




Grafikoni Nr.1. Numri i trajnimeve, ditëve dhe pjesëmarrjes në PTV, Janar-Dhjetor 2022

Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën janar-dhjetor 2022

Penale	71	Kundërvajtje	3
Civile	16	Kushtetuese	1
Drejtësia për Fëmijë – Civile	2	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	2
Drejtësia për Fëmijë – Penale	6	KEDNJ	14

Ekonomike	13	E drejtë e BE-së	1
Administrative	7	E drejte e Punës	1
Ndërmjetësimi	3	Interdisiplinare	3



Grafikoni Nr.2. Numri i trajnimeve te realizuara ne PTV-e sipas fushave, Janar-Dhjetor 2022

Numri i Trajnimeve të realizuara në PTV në Bashkëpunim me Donatorët 2022

Trajnimet e financuara me donatorë	Totali
Akademia e Drejtësisë	69
Mbështetje te Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit për Ndihmë Shtetërore	1
Ambasada Amerikane	18
Bashkimi Evropian - EUKOJUST	5
Bashkimi Evropian Kosovë - Mbështetja e BE-së për Sistemin e të Drejtave Pronësore Intelektuale në Kosovë	2
EULEX	3
GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	6

Humanitarian Law Center Kosovo	1
ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës	1
INJECT	1
I PROCEEDS	1
IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	3
Këshilli i Evropës - JUFREX (Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe)	6
OSBE	4
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - KRCT	1
Qendra Kosovare për Studime Gjinore	3
Shkolla e Magjistratut në Shqipëri	1
UNDP	2
UNHCR	1
USAID / Drejtësia Komerciale	13
US-DOJ/OPDAT	1
Totali	143

Trajnimet për bashkëpunëtor profesional

Pozicioni i bashkëpunëtorëve profesional është i rëndësishëm se veçante dhe ndikon në zhvillimin, avancimin dhe ngritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor. Akademia e Drejtësisë përmes hartimit të kurikules trajnuese dhe zhvillimit të trajnimeve profesionale ka shprehë gatishmëri për mbështetjen e bashkëpunëtorëve profesional në përmbushjen e nevojave gjatë punës së tyre të përditshme.

Në kuadër të kësaj në bashkëpunim me ekspertet nga sistemi gjyqësor dhe në mbështetje të partnerëve të saj, ka hartuar dhe zbatuar modulën për trajnimin bazik të bashkëpunëtorëve profesional në fushën e drejtësisë penale, të ndarë në dy pjesë aspektin material dhe procedural, duke përfshirë edhe formën e vendimeve gjyqësore për çështje të ndryshme ligjore.

Trajnimet e ofruara kanë synuar ngritjen e vazhdueshme profesionale si dhe ngritjen e performacës së sistemit gjyqësor e prokurorial në zbatimin e efikas të standardeve për sundimin e ligjit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, në kuadër të PTV-së, për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtarë ligjorë janë realizuar 12 trajnime në lëmin penal material. Me qëllim të gjithëpërfshirjes këto tema janë ndara për 4 grupe të përfituesve:

Temat e trajtuara:

- Zbatimi i Ligjit më të favorshëm,
- Shkaqet e Përgjegjësisë të Kundërligjshmërisë,
- Pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe
- Veprat Penale kundër integritetit Seksual.

- Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI,
- Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.
- Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit.

Të gjitha temat e lartshënuar janë trajtuar me kohëzgjatje një (1) ditore për katër (4) grupe të ndryshme.


Gjithashtu gjatë periudhës raportuese janë realizua edhe 11 trajnime nga lemia penale procedurale për bashkëpunëtorë profesional.

Temat e trajtuara:

- Fazat e procedurës penale, 4 grupe
- Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi, 3 grupe
- Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta, 4 grupe

Të gjitha temat e lartshënuar janë trajtuar me kohëzgjatje një (1) ditore për tre (3) grupe të ndryshme.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, në kuadër të PTV-së për Bashkëpunëtorë profesional / Zyrtar ligjor nga Moduli bazik janë realizuar: 23 trajnime, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 748, prej tyre 285 meshkuj, 463 femra.



Grafikoni Nr.3. Numri i trajnimeve të realizuara për Bashkëpunëtorë Profesional/Zyrtar Ligjor, Janar-Dhjetor 2022

Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial


Në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive nuk mund të lihet anash edhe roli dhe rëndësia e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

AD përmes programit trajnues ka ofruar trajnime profesionale edhe për stafin administrativ. Këto trajnime kanë pasur për qëllim ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në gjykata dhe prokurori.

Përfitues të trajnimeve janë bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjorë, administratorët dhe ndihmës administrator, kategori që kontribuojnë në zhvillimin e një administrate moderne, profesionale, efektive dhe transparente. Gjithashtu kategori tjetër përfituese janë: shefat e zyrave për menaxhimin e lëndëve, zyrtarët për informimi, referentët, zyrtarët e statistikave dhe sekretarët juridike.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar 10 aktivitetet trajnuese si më poshtë:

1. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor;
2. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial;
3. Dhuna në familje
4. Shkathësitë në komunikimi;
5. Integriteti dhe sjelljet etike;
6. Menaxhimi i kohës dhe stresit;
7. Trajnim në përdorimin e Sistemit Informativ të Lëndëve;
8. Trajnim për protokoll;
9. Mbrojtja e sinjalizuesve;
10. Mirëmbajtja e faqeve të gjykatave në Facebook dhe informimi i publikut përmes tyre.




Grafikoni Nr.4. Numri i trajnimeve të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, Janar-Dhjetor 2022

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ ka realizuar pesë (5) aktivitetet trajnuese me zyrtarë për Ndihmë Juridike Falas si në vijim:

- Ligji për të drejtën sendore dhe praktika gjyqësore në të drejtën pronësore;
- Praktika gjyqësore në kontestet e punës;
- Barazia gjinore në çështjet pronësore të pronësisë së përbashkët;
- Ligji i Punës;
- Praktika dhe vendimet e GJEDNJ.




Grafikoni Nr.5. Numri i Trajnimeve të realizuar në PTV për ANJF

Mbrojtësit e viktimave

Roli i mbrojtësve të viktimave është mbrojtja, ofrimi i keshillave si dhe perkrhja e të drejtave të viktimave të krimit. Akademia e Drejtësisë me qëllim të fuqizimit të kësaj kategorie në bashkëpunim me GIZ gjatë periudhës raportuese ka realizuar tri (3) aktivitetet trajnuese për Mbrojtësit e viktimave si në vijim:

- Dhuna në familje;
- Kompensimi i viktimave;
- Trafikimi me qenie njerëzore.



1.4 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Programi për Hulumtime dhe Publikime është pjesë e Departamentit të Programit i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial përmes ofrimit të burimeve të nevojshme juridike si dhe zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së përmes analizave dhe veprimtarisë kërkimore.

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë përmes këtij programi kryen analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

1. Aktivitetet në PHP

Gjatë vitit 2022 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete në drejtim të:

- Zbatimit të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues si dhe Planit të punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2023
- Veprimtarisë botuese për nevoja të zbatimit të programit të trajnimit fillestar me theks te zhvillimi i moduleve trajnuese;
- Ofrimit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Hartimit të raporteve në zbatim të masave dhe politikave euro integruese;
- Hartimit dhe publikimit të buletinit informativ në baza mujore;
- Koordinimit me kompaninë kontraktuese për furnizimin me materialet e nevojshme për shtyp dhe shërbime të dizajnit për AD-në si dhe
- Përditësimit të statistikave dhe data bazës me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.

2.1 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2023;

Në kuadër të këtij programi është realizuar procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë dhe stafin mbështetës, i cili ka parapri hartimit të programit trajnues dhe përcaktimit të kurrikulës trajnuese. Ky proces ka kërkuar angazhim dhe përkushtim gjatë gjithë vitit meqenëse i bëhet analizë dhe krahasim të gjithë mekanizmave për vlerësim me qëllim që programi trajnues të jetë i përshtatshëm me nevojat dhe funksionet përkatëse. Në këtë vështrim janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga analiza e formularëve të vlerësimit pas sesioneve trajnues gjatë vitit 2022;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Realizimi i takimeve me trajnues të AD-së, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës si dhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK;
- Shqyrtimi i propozimeve dhe rekomandimeve nga Strategjia për sundimin e Ligjit, dhe dokumentet tjera strategjike të cilat kanë relevancë për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën dhe kërkesat e MSA-së.
- Shqyrtimi i portaleve të gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre si dhe
- Në vazhdimësi është përcjellë agjenda legjislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kishin në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga burimet e lartë përmendura është finalizuar me *Raportin analizë nga vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2023* i cili i ka shërbyer Këshillit Programor të AD-së si autoriteti kompetent dhe profesional sipas Ligjit të AD-së për të përcaktuar prioritetet dhe përmbajtjen e Programit trajnues për vitin 2023.

2.2 Veprimtaria botuese dhe publikimi

Komponentë e rëndësishme e PHP-së janë veprimtaria botuese dhe botimet e saj. Për fushën e botimeve është punuar ngushtë me ARF kompaninë kontraktuese të AD-së për shtyp dhe dizajn dhe është monitoruar procesi deri në finalizimin e tyre. Sipas kësaj kontrate janë realizuar 22 porosi, në kuadër të cilave janë botimet e moduleve trajnuese, programet dhe artikuj tjerë të planifikuar sipas kontratës. Në pajtim me kërkesat ligjore është vepruar në bazë të mjeteve të zotuar dhe Urdhër-blerjeve të lëshuara nga ana e Akademisë së Drejtësisë. Vlera totale e kontratës deri në 18.06.2023 është 19,488.80€. Në periudhën raportuese deri në dhjetor 2022 janë shpenzuar 11,125.63 €, përkatësisht 9,619.83€ pasi që disa nga porositë janë në proces e sipër dhe pritet të realizohen në fillim të muajit janar të vitit 2024.

Në funksion të zbatimit të Programit të Trajnimit Fillestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX, PHP është angazhuar drejtpërdrejtë në realizimin dhe shtypjen e moduleve trajnuese dhe Programit të PTF-së si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;
- PTF për Gjyqtarët e sapo emëruar;
- PTF për prokurorët e sapo emëruar.

Për nevojat e zbatimit të trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive është rishtypur në sasinë prej 47 ekzemplarëve Moduli i Trajnimit bazik, aspekti penal- material dhe procedural si dhe Moduli bazik, aspekti civil-material dhe procedural.

Për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë publikuar botimet si në vijim:


- Plani i punës dhe i performancës për vitin 2023 i AD-së
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2021
- Programi i Trajnimit për vitin 2023

Është vazhduar përgatitja dhe publikimi i Buletinit informativ të AD-së me qëllim të njoftimit të të gjitha aktiviteteve të realizuara në baza mujore.

2.3 Ofrimi i burimeve ligjore vendore dhe qasjes në burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë

Programi i PHP-së ka qenë i angazhuar në ofrimin e burimeve ligjore sipas kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit. Në periudhën raportuese janë ofruar shërbime për qasje të materialeve ligjore që gjenden në data bazën e bibliotekës elektronike të AD-së. Kërkesat për materiale ligjore kanë qenë kryesisht në kategorinë e komentareve ligjor dhe doracakëve dhe kjo më tepër nga praktikantët, studentët dhe bashkëpunëtorët profesional e më pak nga gjyqtarët dhe prokurorët, meqenëse ata janë pajisë me formatet fizike shumë kohë më parë. Një pjesë e konsiderueshme e materialeve ligjore elektronike janë të publikuara edhe në faqen e AD-së.

Në mungesë të veglës për identifikimin e numrit të përdoruesve të bibliotekës elektronike ligjore në vijim gjendet numri i përdoruesve të faqes së AD-së që mund të jetë impakt edhe për bibliotekën.



Biblioteka ligjore e materialeve në kopje fizike në periudhën raportuese nuk ka qenë e kërkueshme prandaj edhe me zhvendosjen përkohësisht të AD-së në objektin e ri, kjo bibliotekë nuk është funksionalizuar.

Me qëllim që përfituesve të saj t'iu ofrohen edhe resurse dhe burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë, AD ka vazhduar anëtarësimin në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion. Në këtë mënyrë gjatë vitit 2022 ka mundur për përfituesit e saj sipas ligjit dhe komunitetin tjetër ligjor qasjen në data bazat e natyrës ligjore dhe të përgjithshme si në vijim:

- **IOP science** që ka mundur studiuesit të hyjnë në përmbajtje shkencore, teknike dhe mjekësore.
- **Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare** e cila ka përfshirë traktatet autoritative, të cilat vazhdojnë definimin e fushave të tyre të së drejtës, punimet referuese dhe komentaret e Black-letter që ndihmojnë në përgjigjen ndaj disa pyetjeve praktike të së drejtës dhe publikime të cilat ofrojnë këndvështrime inovative për problemet aktuale ligjore.
- **Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare** që ka ofruar artikuj enciklopedik lidhur me më shumë se 1600 çështje ligjore ndërkombëtare, koncepte dhe raste.
